



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/28
Datë: 14.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 22 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ragmi Dalipi emërohet në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Digjitalizimit dhe e Administratës Publike për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Ky Vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa hyn në fuqi nga data 15 gusht 2026.

Albin KURTI


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/28
Datë: 14.07.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Gjakovës:
 - Administrimi i objektit të ish-"Bankos"-it për nevoja të administratës së Komunës së Gjakovës, Zona Kadastrale Gjakovë - Qytet, Komuna e Gjakovës; dhe
 - Ndërtimi i Fushës së Futbollit dhe i hapësirave rekreative për fshatin Trakaniq dhe fshatrat rreth zonës Trakaniq, zona kadastrale Trakaniq, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit, të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar, në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, subjekti kërkues - Komuna e Gjakovës do ta paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
8. Subjekti kërkues - Komuna e Gjakovës do t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare, që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit, dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/28
Datë: 14.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 40 të Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadashtër të Pronës së Paluajtshme, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2024 për Komisionet dhe Nënkomisionet për Rindërtimin e Kadastrës dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 11/08, të datës 3 prill 2026

1. Ndryshohet dhe plotësohet nënparagrafi 2.2, i paragrafit 2, të Vendimit Nr. 11/08, të datës 3 prill 2026: znj. Ervina Gashi, Zyra e Kryeministrit, zëvendësuese e anëtarit, zëvendësohet nga znj. Besnike Mehmeti, Zyra e Kryeministrit, zëvendësuese e anëtarit.
2. Dispozitat e tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 11/08, të datës 3 prill 2026, mbeten të pandryshuara.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 11/08, të datës 3 prill 2026.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë